

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

1(nje) Inxhinier Ndertimi

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

1. Te marre pjese ne studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të konsumatorëve të veçantë ose zonave të banuara.
2. Bën përditësimin e rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura.
3. Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës.
4. Është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri të konsumatori.
5. Garanton largimit efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.
6. Në mungesë të Administratorit, për arsye objektive, përfaqëson Shoqërinë në të gjithë aktivitetin dhe veprimtarinë e saj teknike, si edhe në marrëdhëniet me të tretët vetëm mbi bazën e një autorizimi të lëshuar nga Administratori.
7. Përgjigjet përpara Administratorit për hartimin e planit të Investimeve (pjesë e planit të zhvillimit të Shoqërisë) me fonde buxhetore apo vetëfinancim si dhe hartimin e projekt-preventivave përkatëse.
8. Është përgjegjës për arritjen e objektivave afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të përcaktuara nga Buxheti i Shoqërisë apo vendime të tjera të strukturave drejtuese të Shoqërisë
9. Ka të drejtë të propozojë ndryshime në strukturën organizative të Departamentit.

10. Harton dhe propozon metodologji, procedura standarde operimi dhe politika për çështje që lidhen me veprimtarinë teknike të Shoqërisë.
11. Kontrollon dhe nënshkruan projekt-preventivat e zbatimit të hartuara nga Sektori i Projektive dhe mban përgjegjësi për zgjidhjet teknike.
12. Drejton punën për koordinimin, menaxhimin e kolaudimin e zbatimit të projekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura dhe marrjen në dorëzim në afatet e caktuara në ligj dhe për kushtet teknike të zbatimit të tyre
13. Organizon, ndjek dhe kontrollon të gjithë veprimtarinë teknike të departamentit teknik si dhe veprimtarinë teknike të NjO-ve.
14. Për raste të vecanta në bashkëpunim me sektorin teknik , përgatit preventivat për sasinë e faturimit të objekteve që faturohen me sasi fikse, në të cilat nuk është i mundur instalimi i matësit
15. Kryen çdo detyrë tjetër me kërkesë të Administratorit dhe në përshtatje me natyrën e punës së tij.

Kandidatet duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jeni shtetas shqiptarë .
- ✓ Të ketë përfunduar studimet e larta universitare, në shkencat inxhinierike, në degën inxhinieri ndërtimi.
- ✓ Te jeni në gjendje të mirë shëndetësore dhe të aftë fizikisht.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DORËZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Punë
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 10 dite.

Kandidatet do te vleresohen ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar.

Ne perfundim te vleresimit te kandidateve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do te shpalle fituesit ne portalin “ Sherbimi Kombetar I Punesimit”, ne faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kane te drejte te ankimohen prane Drejtorise se Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit eshte 3 (tre) dite nga data e shpalljes se fituesit.

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

1(nje) Inxhinier Hidroteknik

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

- ✓ Objekti kryesor i veprimtarisë së saj është:
- ✓ Administrimi i drejtpërdrejte përfshirë operimin dhe mirëmbajtjen e veprave kryesore hidrike të SHRUKSH-se përfshirë puset, stacionet e pompimit, kaptazhet, pus shuarësit, depot dhe linjat e transmetimit në funksion të tyre.
- ✓ Administrimi i tërthortë nëpërmjet kontrollit, monitorimit dhe mbështetjes teknike për të gjithë veprat e tjera hidrike në funksion të prodhimit dhe transmetimit në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Rajonale UKSH. Administrimi i drejtpërdrejte përfshirë operimin dhe mirëmbajtjen e tyre të përditshme është përgjegjësi e NjO-së përkatëse.
- ✓ Administrimi i tërthortë nëpërmjet kontrollit, monitorimit dhe mbështetjes teknike për të gjithë rrjetet shpërndarëse përfshirë depot, stacionet e pompimit, linjat kryesore dhe dytësore të shpërndarjes dhe pikat e lidhjeve të konsumatorëve në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Rajonale UKSH. Administrimi i drejtpërdrejte përfshirë operimin dhe mirëmbajtjen e tyre të përditshme është përgjegjësi e NjO-së përkatëse.
- ✓ Garantimi i prodhimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit që mbulohet nga Shoqëria.
- ✓ Sigurimi i gatishmërisë teknike në të gjithë veprat hidrike përfshirë puset, stacionet e pompimit, kaptazhet, pus shuarësit, depot dhe linjat e transmetimit në funksion të tyre si dhe sigurimi i gatishmërisë teknike në të gjithë skemat shpërndarëse.
- ✓ Garantimin e cilësisë së ujit që futet në rrjetin shpërndarës nëpërmjet klorinimit dhe monitorimit të vazhdueshëm.
- ✓ Ndjekja me përparësi e rasteve të ndotjeve të ujit të pijshëm deri në zgjidhjen e tyre.

Mban përgjegjësi, sipas shkallës së dëmit dhe rrezikshmërisë, për të gjitha veprimet e kryera në kundërshtim me Urdhrat e dhëna nga Eprorët, apo për mos realizimin në afat dhe me cilësi të detyrave të ngarkuara

Kandidatet duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Të ketë përfunduar studimet ë larta universitare,në shkencat inxhinierike, në degën inxhinieri hidroteknik.
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 10 dite.

Kandidatet do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , Drejtorja e Burimeve Njerezore do të shpallë fituesit në portalin “ Sherbimi Kombëtar I Punësimit”, në faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit është 3 (tre) dite nga data e shpalljes së fituesit.

